



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 155, datë 31.08.2023

PËR

**MIRATIMIN E NJOHJES SË NËNFONDEVE TË SIKTT “EURIZON FUND”:
“AZIONI STRATEGIA FLESSIBILE” DHE “EQUITY WORLD SMART
VOLATILITY”, MIRATUAR NGA CSSF NË LUKSEMBURG, NËN ADMINISTRIMIN
E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË NJOHUR “EURIZON CAPITAL” S.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 94 dhe 96, të ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe rregullores nr. 37, datë 31.03.2023 “Për njohjen e shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuar në një vend anëtar të BE-së dhe njohjen e sipërmarrjes së investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuar në një vend anëtar të BE-së”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e njohjes së nënfondeve të SIKTT “Eurizon Fund”: “Azioni Strategia Flessibile” dhe “Equity World Smart Volatility”, miratuar nga CSSF në Luksemburg, nën administrimin e shoqërisë administruese të njohur “Eurizon Capital” S.A., të cilat do të marketohen dhe shiten në Republikën e Shqipërisë.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**